

# Vetëmbroje email kundër survejimit

Survejimi masiv dhunon të drejtat tonë themelore dhe është kërcënëm për lirinë e fjalës!

Por: mund të mbrojmë vetveten.



## Problemi

Fjalëkalimi që mbron email-in tuaj s'është i mjaftueshëm për mbrojtjen e mesazheve tuaj nga teknologjite e survejimit në masë të përdorura nga shërbimet sekrete.

Çdo email i dërguar përmes internetit kalon nëpër shumë sisteme kompjuterikë, gjatë rrugës së tij drejt vendmbërritjes. Shërbimet sekrete dhe agjencitë e survejimit përfitojnë prej kësaj për të lexuar miliona e miliona email-e çdo ditë.

Edhe nëse mendoni se s'keni asgjë për të fshehu: Gjithkush me të cilin ju komunikoni me anë email-esh të pafshehtëzuar, ekspozohet po njësoj.

## Fshehtëzimi

Rifitoni privatësinë duke përdor GnuPG-në! I fshehtëzon email-et tuaja para se të dërgohen, që vetëm marrësit që zgjidhnë ju të mund t'i lexojnë.

GnuPG-ja është i pavarur nga platformat. Kjo do të thotë që funksionon me çfarëdo adresë email dhe xhiron thuajse në çfarëdo kompjuteri, apo telefoni celular të kohëve të fundit. GnuPG-ja është i lirë dhe pa pagesë.

Mijëra persona e përdorin tashmë GnuPG, për përdorim profesional dhe privat. Ejani dhe ju me ne! Çdo person e bën bashkësinë më të fortë dhe dëshmon se jemi gati të kundërpërgjigjemi.

## Zgjidhja

Kurdo që një email i fshehtëzuar me GnuPG-në kapet ose përfundon në duar të gabuara, është i pavlerë: Pa kyçin e duhur privat nuk mund të lexohet nga ndokush. Por, për marrësin e duhur – dhe vetëm për të – hapet si email krejt i zakonshëm.

Dërguesi dhe marrësi tanë janë që të dy të parrezikuar. Edhe pse disa nga email-et tuaj nuk përbajnë ndonjë të dhënë private, përdorimi i vazhdueshëm i fshehtëzimit na mbron të gjithëve nga survejimi i papërligjut masiv.

## Komunikim privat me email



**Rifitoni privatësinë tuaj!  
Përdorni GnuPG-në!**




- Software i Lirë
- për krejt adresat email
- për GNU/Linux, Windows, Mac, Android, ...
- s'ka nevojë për llogari ose regjistrim
- pa pagesë

# Si funksionon GnuPG-ja

Që tē përdorni fshehtëzim GnuPG, ju krijoni një çift unik "kyçesh", publik dhe privat.

Këto kyçe përdoren kështu

## kyç publik




### fshehtëzim

Kur dikush dëshiron t'ju dërgojë një email të fshehtëzuar, atij i duhet tē përdorë "kyçin tuaj publik". Ndaj, sa më tepër ta përhapni/shpërndani kyçin tuaj publik, aq më mirë.

Mos u shqetësoni: Kyçi juaj publik mund tē përdoret vetëm pér tē fshehtëzuar email-e dërguar juve, jo pér çfshehtëzuar ata.

## kyç privat



### çfshehtëzim

"Kyçi juaj privat" është pak a shumë si kyçi i derës së shtëpisë suaj; e ruani në një vend tē parrezik (dhe privat) te kompjuteri juaj. Kujdesuni që tē jeni i vetmi që mund ta përdorë! Pér tē çfshehtëzuar dhe lexuar krejt email-et që ju dërgohen, përdoret GnuPG-ja dhe kyçi juaj privat.

## Çfarë e bën tē sigurt GnuPG-në?

GnuPG-ja është **Software i Lirë** dhe përdor **Standarde të Hapura**. Kjo ka rëndësi thelbësore pér t'u siguruar që software-i mund tē na mbrojë vërtet nga survejimi. Sepse nē software dhe formate pronësorë, gjërat mund tē bëhen jashtë kontrollit tonë.

Nëse askujt s'i lejohet tē shohë kodin burim tē një programi, askush s'mund tē jetë i sigurt se programi s'përmban copëza tē padëshirueshme spiunimi – tē ashtuquajturat "deriçka". Po qe se nuk kuptohet se si funksionon software-i, mund t'i zëmë besë vetëm qorrazi. Përkundrazi, një kusht themelor i Software-it tē Lirë është publikimi i kodit tē tij burim: Software-i i Lirë e lejon dhe e përkrah kontrollin e pavarur dhe shqyrtimin publik tē kodit burim nga cilido. Me këtë transparencë, derikat mund tē zbulohen dhe hiqen nga programi.

Shumica e Software-it tē Lirë gjendet në duart e një bashkësie që punon tok pér tē ndërtuar software tē sigurt pér këdo. Nëse doni tē mbronи veten nga survejimi, duhet t'i besoni vetëm Software-it tē Lirë.

## Ç'është Software-i i Lirë?

Software-i i Lirë mund tē përdoret nga cilido, pér çfarëdo qëllimi. Kjo përfshin kopjimin e lirë tē tij, leximin e kodit burim dhe mundësinë pér ta përmirësuar ose përshtatur pér nevojat e secilit (tē ashtuquajturat "katër liritë").

Edhe nëse "doni vetëm ta përdorni" programin, prapë përfiton nga këto liri. Ngaqë ato garantojnë që Software-i i Lirë mbetet përherë nē duart e shoqërisë sonë dhe që zhvillimi i mëtejshëm i tij s'kontrollohet nga interesa kompanish private apo qeverish.

Mësoni më tepër rreth këtyre dhe se si Software-i i Lirë mund tē na shpjerë nē një Shoqëri tē Lirë:

[fsfe.org/freesoftware](http://fsfe.org/freesoftware)

## Këshilla praktike

Teknologjia pas GnuPG-së ofron mbrojtje tē klasit tē parë. Udhëzimet e mëposhtme do t'ju ndihmojnë tē siguroni që komunikimi juaj i fshehtëzuar tē mos komprometohet pér shkaqe tē tjera:

Pér tē çfshehtëzuar email-et tuaj ju duhet kyçi juaj privat dhe **fjalëkalimi juaj**. Ky fjalëkalim duhet tē jetë e pakta 8 shenja i gjatë dhe tē përbajë shifra, shenja speciale si dhe shkronja tē mëdha dhe tē vogla. Pér më tepër, askush që ju njeh ndopak s'duhet tē jetë gjendje ta zbulojë fjalëkalimin tuaj.

**Bëjini kyçit tuaj privat një kopjeruatje!** Nëse disku juaj prishet, nuk lypset tē krijoni një tē ri dhe as nuk humbni tē dhënat tuaja.

**Fshehtëzoni sa më tepër që mundeni!** Duke bërë kështu, ua bëni tē vështirë tē tjerëve tē kuptojnë se kur dhe me kë shkëmbeni tē dhëna me spec. Ndaj, sa më shpesh t'i fshehtëzoni mesazhet tuaja, më pak dyshime do tē lindin pér to.

Mbani parasysh që **subjekti i mesazhit transmetohet i pafshehtëzuar!**

## Përkujdesore

Një përkujdesore tē thjeshtë pér vetëmbrojtje email-i me fshehtëzim GnuPG mund ta gjeni këtu:

### EmailSelfDefense.FSF.org

Ose hapni sytë pér ndonjë nga tē ashtuquajturat "**Cryptoparties**" nē zonën tuaj. Këto janë veprimitari nē tē cilat mund tē takoheni me njerëz që do tē ishin tē lumtur t'ju ndihmonin, pa pagesë, tē regullonit dhe përdornit GnuPG-në, si dhe mjete tē tjera fshehtëzimi.

2016-04-04



Kjo fletëpalosje është ripunim nga FSFE-ja i një materiali original tē FSF-së dhe Journalism++ (CC BY 4.0) që mund ta gjeni te: [emailselfdefense.fsf.org](http://emailselfdefense.fsf.org)

## Rreth FSFE-së

Kjo fletëpalosje u krijua nga Free Software Foundation Europe (FSFE), një organizëm joftimprurës, i përkushtuar promovimit tē Software-it tē Lirë dhe punës pér ndërtimin e një shoqërie dixhitale tē lirë.

Shkalla e lirisë sonë mbi software-in përcakton shkallën e pjesëmarrjes në shoqëri. Ndaj duke luftuar pér liri dixhitale, FSFE-ja lufton pér mundësi tē barabarta dhe pjesëmarrje pér këdo nē epokën e informacionit.

Askush s'duhet tē detyrohet tē përdorë software që s'garanton lirinë e **përdorimit, studimit, ndarjes me tē tjerët dhe përmirësimt tē tij**. Na duhet e drejta t'i japid teknologjisë atë formë që përshtatet me nevojat tona.

Puna e FSFE-së ka nga pas një bashkësi njerëzish tē përkushtuar këtyre qëllimeve. Nëse dëshironi tē vini me ne dhe/ose tē na ndihmoni tē arrimjë këto synime, ka plot rrugë pér tē dhënë ndihmesë. Pavarësisht se nga ç'fushë vini. Më tepër rreth kësaj, dhe se si mund tē na përkrahni nē punën tonë, mund tē mësoni tē:

[fsfe.org/contribute](http://fsfe.org/contribute)

## Bëhuni anëtar mbështetës!

Që tē mund tē vazhdojmë punën tonë dhe tē garantojmë pavarësinë tonë, dhurimet janë jetike pér ne. Rruga më e mirë pér tē përkrahur punën tonë është tē bëheni një anëtar që ndihmon financiarisht FSFE-në, "Anëtar Shok". Kështu na ndihmoni drejtësëdrejtë tē vazhdojmë betejën pér Software-in e Lirë kurdo që tē jetë e nevojshme.

[fsfe.org/join](http://fsfe.org/join)

Këtë, dhe tē tjera fletëpalosje, mund t'i porositni pa pagesë te:

[fsfe.org/promo](http://fsfe.org/promo)

Free Software Foundation Europe e.V.  
Schönhäuser Allee 6/7  
10119 Berlin  
Germany  
<https://fsfe.org>

